



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

VENDIM

Nr. 60, datë 30.01.2020

**PËR
MIRATIMIN E UDHËZUESIT “PËR PLOTËSIMIN E TABELAVE ME TË DHËNA
STATISTIKORE PËR EFEKT TË VLERËSIMIT ETIK DHE PROFESIONAL TË
GJYQ TARËVE”**

Këshilli i Lartë Gjyqësor bazuar në nenin 147 pika 1 shkronja “a” të Kushtetutës, nenin 61 pika 2 dhe 94 pika 4 shkronja “dh” të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së drejtësisë”, i ndryshuar, nenet 2, 68-72, 74-78, 84-95, 97 dhe 171 të ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, Vendimin nr. 316 datë 19.12.2019 “Për miratimin e tabelave me të dhëna statistikore të nevojshme për efekt të vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarëve”, me propozimin e Komisionit të Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale,

VENDOSI:

1. Miratimin e Udhëzuesit “Për plotësimin e tabelave me të dhëna statistikore për efekt të vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarëve”, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi me botimin në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR